



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 258, Datë 20/12/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 79, datë 30.05.2018, e Znj. E. K., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Korçë dhe Ujësjiellës Kanalizime sh.a., Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se familja e E. K., e cila përbëhet nga 4 persona², trajtohet me ndihmë ekonomike, pasi të dy bashkëshortët janë të papunë. Bashkëshorti i ankueses, Z. Gj. H. është i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë si punëkërkuar i papunë³, por ende nuk është punësuar. Referuar vendimit të KMCAK Korçë, datë 05.07.2017, djali i tyre, 15 vjeçar vuan nga autizmi. Të ardhurat e kësaj familjeje konsistojnë në ndihmën

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

² Referuar çertifikatës familjare, së lëshuar nga ZGJC, Njësia Administrative Korçë 234, Nr. 014212907, datë 04.06.2018.

³ Referuar Vërtetimit nr. 475, datë 04.06.2018, të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë.

ekonomike, si dhe pagesën e kujdestarisë dhe të aftësisë së kufizuar, që shteti jep për djalin e tyre autik.

Për sa më sipër, ankuesja thekson faktin, se është debitore ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Korçë dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a., Korçë dhe e ka të pamundur të shlyejë detyrimet e prapambetura ndaj dy shoqërive, në kushtet e vështira ekonomike, në të cilat ndodhet familja e saj. OSHEE sh.a Korçë, fillimisht, e ka ndërprerë furnizimin me energji elektrike për familjen e ankueses, por në vijim e ka rilidhur, pasi ka konstatuar gjendjen e vështirë ekonomike, në të cilën ndodhej kjo familje.

Për sa më sipër, ankuesja kërkon të përfitojë nga skemat lehtësuese të OSHEE sh.a. dhe UK Korçë, duke qënë se familja e saj bën pjesë në kategorinë e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe në kushtet kur djali i saj është me aftësi të kufizuara. Njëkohësisht, ajo kërkon nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë⁴, dhënien e mundësisë për punësimin e bashkëshortit të saj, Z. Gj. H. Një tjetër pretendim i E. K. është që t'i njihet si vjetërsi pune koha, që ajo i kushton djalit të saj autik në cilësinë e kujdestares.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

A. Pas kryerjes së procesit të plotësimit me dokumentacionin e nevojshëm të ankesës nr. 58, datë 07.05.2018, e Znj. E. K., si dhe pas analizimit të saj paraprak, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Korçë dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a., Korçë, me shkresën nr. 785/1, datë 13.06.2018, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesja, si më poshtë vijon:

- Informacion mbi debinë e ankueses ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Korçë dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a., Korçë;
- Mundësia e kryerjes së pagesës së detyrimeve të prapambetura të ankueses, duke përfituar nga skemat lehtësuese të ofruara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë

⁴Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë nuk është subjekt kundër së cilit drejtohet ankesa, por kërkohet bashkëpunimi i saj, për punësimin e bashkëshortit të ankueses.

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Elektrike (OSHEE) sh.a., Korçë dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a., Korçë, në kushtet kur familja e saj është përfituese e ndihmës ekonomike dhe ka në përbërje të saj një person me aftësi të kufizuara.

- Dhënien e mundësinë për punësimin e bashkëshortit të saj nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë.

Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dhe ankueses.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 785/1, datë 13.06.2018, së Komisionerit, OSHEE Korçë dërgoi shkresën nr. 785/2, datë 22.06.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin se kontrata e furnizimit me energji elektrike, me kod KR0A060030010087, është në emër të bashkëshortit të ankueses, Z. Gj. H.. Debia për këtë kontratë deri në datën 19.06.2018 përfshin faturat për periudhën **Janar 2017-Maj 2018** dhe përfshin shumën totale 87 302,80 lekë.

Në shkresë theksohet fakti se, sipas legjislacionit në fuqi, që një debitor të përfitojë nga skemat lehtësuese të OSHEE, duhet që debia të jetë para muajit janar 2017. Pra, për periudhën Janar 2017 e në vazhdim konsumatori nuk duhet të jetë debitor. Rasti në fjalë është debitor për këtë periudhë dhe për rrjedhojë nuk përfiton nga skemat lehtësuese të OSHEE sh.a.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 785/1, datë 13.06.2018, së Komisionerit, Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a., dërgoi shkresën nr. 356/1, datë 25.06.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin se klienti Gj. H. është i regjistruar në sistemin e faturimit të shoqërisë me numër klienti 701548. Detyrimi për këtë klient në datën 25.06.2018 është 261.840 lekë dhe përfshin detyrimet e prapambetura prej muajit mars 2010. Pagesa e fundit e këtij klienti është kryer në datën 05.10.2015 dhe UK Korçë sh.a., i ka ofruar klientit mundësinë e nënshkrimit të një aktmarrëveshjeje për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me pjesë sipas mundësisë. Klienti vazhdon të furnizohet me ujë nga UKKO, pavarësisht faktit që ka detyrime të prapambetura dhe konsumi i faturuar është në bazë të regjistrimeve të aparatit matës.
3. Në përgjigje të shkresës nr. 785/1, datë 13.06.2018, së Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dërgoi shkresën nr. 543, datë 19.06.2018, nëpërmjet së cilës informon se Z. Gj. H. është i regjistruar si punëkërkuar i papunë pranë këtij institucioni. Rasti i tij është konsideruar me prioritet nga ana e DRSHPK Korçë dhe në shkresë shprehet gatishmëria e këtij institucioni për të gjetur mundësi punësimi për të, në përputhje me kushtet e tij familjare.

C. Për të administruar më tepër informacion lidhur me pjesën e ankesës së E. K. ndaj OSHEE sh.a. Korçë, KMD dërgoi pranë kësaj shoqërie shkresën nr. 785/5, datë 06.08.2018,

nëpërmjet së cilës, pas parashtrimit të situatës së familjes së ankueses dhe përgjigjes zyrtare të dërguar nga OSHEE sh.a., Korçë, kërkohet informacion mbi çështjet e mëposhtëme:

- Duke qënë se në shkresën nr. 785/2, datë 22.06.2018, të OSHEE sh.a., Korçë nuk specifikohet legjislacioni, që parashkonte skemat lehtësuese, u kërkua të identifikohet akti përkatës, i cili përcakton periudhat e detyrimeve të prapambetura dhe mundësinë e përfitimit nga skemat lehtësuese për familjet, që i përkasin kategorive të veçanta. Bashkëlidhur informacionit u kërkua të dërgohej një kopje e këtij akti.
- Informacion mbi arsyet, që familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe kanë detyrime të prapambetura nga janari 2017 e në vijim ndaj OSHEE sh.a., nuk përfshihen në skemat lehtësuese të kësaj shoqërie.
- Informacion mbi mënyrën se si është menduar të veprohet me familjet, që i përkasin kategorive në nevojë, të cilat ndodhen në situatën e familjes së ankueses.

Në shkresën e KMD-së u përcaktua si afat për dërgimin e informacionit të kërkuar data 09.09.2018.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 785/5, datë 06.08.2018, së KMD-së, OSHEE sh.a. dërgoi shkresën nr. 1157, datë 20.08.2018, ku Komisioneri informohej lidhur me sa më sipër. Në lidhje me çështjen e parë të parashtruar nga KMD, OSHEE sh.a. sqaron se me qëllim mundësimin e lehtësimit të kushteve ndaj klientëve familjarë, të cilët paguajnë detyrimet e prapambetura të energjisë elektrike, përfshirë edhe familjet e kategorizuara në skemën e ndihmës ekonomike, Këshilli Mbikqyrës i OSHEE sh.a. ka miratuar Vendimin nr. 64, datë 27.12.2017 “Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë lektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jo familjarë”, ku janë përcaktuar skemat lehtësuese për pagesën e këtyre detyrimeve.

Lidhur me çështjen e dytë, OSHEE sh.a. sqaron se përfshirja në Aktmarrëveshje sipas kushteve të përcaktuara në vendimin e sipërpërmendur të Këshillit Mbikqyrës, nënkupton krijimin e lehtësirave, që kjo shoqëri ka ofruar për pagesën e detyrimeve të prapambetura për klientët e saj debitorë, përmes skemës së pagesës me këste, duke krijuar mundësinë reale për arkëtimin e debive të prapambetura. Qëllimi i hyrjes në Aktmarrëveshje është që klienti favorizohet në pagesën e detyrimeve të prapambetura të akumuluar ndërsa vite. Krahas detyrimeve, të cilat janë objekt i Akt-Marrëveshjes, klienti duhet të paguajë të gjitha detyrimet e faturave korente të muajve respektive, për të cilët ka konsum energjie apo tarifë shërbimi, duke pranuar dhe përgjegjësitë, të cilat rrjedhin nga mos shlyerja e këtyre detyrimeve. Sa më sipër, shoqëria “OSHEE” sh.a. ka marrë të gjitha masat për t’u siguruar të gjithë klientëve të saj barazi në trajtim.

Lidhur me çështjen e tretë, OSHEE sh.a. sqaron se ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për mbështetjen e shërbimeve të reja, të përkujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale, ka përcaktuar

edhe institucionet përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore. Shoqëria OSHEE sh.a., si një shoqëri tregëtare që ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar, me objekt veprimtarie furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, nën frymën e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ka ofruar barazi dhe mundësi të barabarta për të ushtruar të drejtat dhe për të gëzuar liritë, si dhe çdo mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo lloj forme sjelljeje që nxit diskriminim, për çdo klient që ka kontratë furnizimi me energji elektrike. Në këtë kuptim, OSHEE sh.a. i ka trajtuar të gjithë klientët debitorë, që bëjnë pjesë në skemën e ndihmës ekonomike, në mënyrë të njëjtë dhe nuk ka preferuar ndonjë debitor mes të tjerëve.

D. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore, në datën 27.09.2018, ndërmjet përfaqësuesve të Shoqërisë OSHEE sh.a dhe ankueses E. K.. Njoftimi i palëve u krye nëpërmjet shkresës nr. 1244, datë 12.09.2018, ku ndër të tjera përfaqësuesve të OSHEE sha. iu kërkua të paraqesin informacion në këtë seancë dëgjimore, lidhur me sa më poshtë vijon:

- Numri i konsumatorëve familjarë të kategorisë “ndihmë ekonomike”, të cilët kanë detyrime të prapambetura ndaj OSHEE sh.a., nga data 01.01.2017 e në vijim;
- Kopje e Relacionit të Vendimit nr. 64, datë 27.12.2017, e Këshillit Mbikqyrës të OSHEE sh.a., “Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jo familjarë”;
- Arsyet dhe qëllimi i vendosjes, në vendimin e sipërpërmendur, të kriterit, sipas së cilit miratohen kushte lehtësuese për likuidimin me këste mujore, të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike, të krijuara deri në datën 31.12.2016 dhe jo pas kësaj date e në vijim, për shtresat në nevojë (pensionistë kryefamiljarë dhe familje që trajtohen me ndihmë ekonomike).

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.09.2018, ankuesja E. K. nuk u paraqit, ndërkohë që në këtë seancë u paraqitën përfaqësuesit e OSHEE sh.a., të cilët dhanë sqarimet e tyre, lidhur me çështjet që përbënin objekt diskutimi. Përfaqësuesit e kësaj shoqërie theksuan faktin se OSHEE sh.a. është person juridik që funksionon si shoqëri aksionere, organizimi i së cilës bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” (i ndryshuar) dhe objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është të ofrojë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes për klientët fundorë në zbatim të kontratës së furnizimit me energji elektrike, të lidhur ndërmjet palëve sipas kushteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë. Me qëllim mundësimin e lehtësimit të kushteve ndaj klientëve familjarë, të cilët paguajnë detyrimet e prapambetura të energjisë elektrike, përfshirë edhe familjet e kategorizuara në skemën e ndihmës ekonomike, Këshilli Mbikqyrës, i cili referuar legjislacionit të shoqërive tregëtare është organ vendimmarrës i shoqërisë OSHEE sh.a., ka miratuar Vendimin nr. 64, datë 27.12.2017 “Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të

prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jo familjarë”, ku janë përcaktuar skemat lehtësuese për pagesën e këtyre detyrimeve.

Përfshirja në Akt-Marrëveshje nënkupton krijimin e lehtësirave që Shoqëria OSHEE sh.a. ka ofruar për pagesën e detyrimeve të prapambetura për klientët e saj debitorë, përmes skemës së pagesës me këste, duke mos i bërë ata objekt të ndërprerjes së energjisë elektrike apo të procesit gjyqësor, si dhe duke krijuar mundësinë reale për arkëtimin e debive të prapambetura.

Me qëllim lehtësimin e mëtejshëm për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura për Klientët Familjarë, OSHEE sh.a. aplikon reduktimin e kamatëvonesës në masën 70% kundrejt pagesës totale për detyrimet e prapambetura (principal + kamatëvonesë) deri në 31.12.2016. Në këtë kuptim, OSHEE sh.a. ka trajtuar të gjithë klientët debitorë, ku bëjnë pjesë klientët familjarë të kategorisë ndihma ekonomike, pensionistët kryefamiljarë, jetimët nën 25 vjeç etj., të cilët shprehin vullnetin të kryejnë pagesën e detyrimit me këste fikse, në mënyrë të barabartë dhe nuk ka preferuar ndonjë debitor ndërmjet të tjerëve.

Lidhur me çështjen e parë të parashtruar nga KMD, ku kërkohet informacion mbi numrin e konsumatorëve familjarë të kategorisë “ndihmë ekonomike”, të cilët kanë detyrime të prapambetura ndaj OSHEE sh.a., nga data 01.01.2017 e në vijim, përfaqësuesit e OSHEE sh.a. sqaruan se referuar nenit 95, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe në konsultim me ERE-n dhe grupet e interesit është përgjegjëse për hartimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pas paraqitjes së setit të dokumentacionit nga klientët e interesuar, ku ndër të tjera kërkohet edhe paraqitja e dokumentit të ndihmës ekonomike apo të statusit të veçantë, informacioni procesohet pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. Në këtë kuadër, përfaqësuesit e OSHEE sh.a. sqaruan se ky numër klientësh përditësohet rast pas rasti sipas kërkesës për lidhje të Akt-Marrëveshjes. Përfaqësuesit e OSHEE sh.a. vunë në dispozicion të Komisionerit të dhënat e përpunuara deri në atë moment, por u sqarua se këto të dhëna nuk ishin të plota, pasi në to nuk ishin përfshirë Elbasani, Durrësi, Burreli dhe Kukësi, si dhe sqaruan më tej se numri i reflektuar në tabela përbënte numrin e përgjithshëm të familjeve në nevojë, por jo sipas kriterit të kërkuar nga KMD, dmth nga 1 janari 2017 e në vijim.

Për sa më sipër, u ra dakord që informacioni i kërkuar nga KMD, do të dërgohej zyrtarisht në ditët në vijim nga OSHEE sh.a.

OSHEE sh.a. depozitoi gjithashtu edhe Relacionin Nr. 1, të Vendimit nr. 64, datë 27.12.2017 “Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jo familjarë”.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, në përgjigje të e-mailit të dërguar në datën 01.10.2018, nga strukturat përgjegjëse të KMD-së, përfaqësuesit e OSHEE sh.a. dërguan e-mailin e

datës 03.10.2018, ku informonin se shoqëria “OSHEE” sh.a. nuk disponon informacion mbi numrin e klientëve në nevojë debitorë nga data 01.01.2017 e në vijim.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Referuar përgjigjeve zyrtare të dërguara nga institucionet, kundrejt së cilave është dërguar ankesa e E. K. rezulton se:

1. Në lidhje me ankesën e E. K. drejtuar OSHEE sh.a., Korçë⁶:

Në bazë të pikës 1, të Vendimit nr. 64, datë 27.12.2017, të Këshillit Mbikqyrës të OSHEE sh.a. “*Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jofamiljarë*” miratohen kushtet lehtësuese për likuidimin me këste mujore, të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike të krijuara deri në datën **31.12.2016**, si më poshtë:

- ⇒ Konsumatorët familjarë që shprehin vullnetin të kryejë pagesën e detyrimit me këste fikse mujore me vlerë 2.800 lekë në muaj;
- ⇒ Konsumatorët familjarë të kategorisë ndihmë ekonomike, pensionistë kryefamiljarë, që shprehin vullnetin të kryejnë pagesën e detyrimit me këste fikse mujore, me vlerë 1.200 lekë në muaj;
- ⇒ Konsumatorët familjarë që shprehin vullnetin të kryejnë pagesën e menjëherëshme të detyrimit, duke përfutur reduktim kamatëvonese në masën 70%.

Sikurse vihet re, ky vendim parashikon skema lehtësuese për ata konsumatorë familjarë që kanë detyrimeve të prapambetura deri në 31 dhjetor 2016. Referuar informacionit të marrë nga OSHEE sh.a., Korçë, E. K. rezulton debitorë për periudhën Janar 2017- Maj 2018, periudhë, e cila nuk përfshihet në vendimin e sipërcituar.

Sikurse rezultoi nga seanca dëgjimore, vendimi i sipërpërmendur ka patur si qëllim të tij, nxitjen e familjeve debitorë, për t'i futur në skemën paguese, pasi këto familje, veç debive të mbartuara duhet të paguajnë edhe faturat korentë. Ky vendim është miratuar në datën 27.12.2017 dhe ka

⁶ Me Urdhërin Nr.454, datë 22.10.2014, të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, aksionet e Shoqërisë OSHEE sha, janë 100% në pronësi të Shtetit shqiptar. Aksioneri i Shoqërisë “OSHEE” për periudhën nga 23.10.2014 deri në 05.05.2016 ka qenë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS). Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 317, datë 27.04.2016 (datë 05.05.2016), **Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “OSHEE” është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.**

përfshirë vitin paraardhës, gjë që nuk përjashton mundësinë e miratimit të një vendimi tjetër nga ana e Këshillit Mbikqyrës, për të krijuar skema lehtësuese për familje, debia e së cilave shtrihet përgjatë një periudhë tjetër kohore, të pambuluar nga Vendimi nr. 64/2017, i Këshillit Mbikqyrës së OSHEE sh.a.. Referuar Relacionit nr. 1, datë 27.12.2017, të Vendimit të sipërpërmendur të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i OSHEE sh.a rezulton se propozimi i bërë nga Administratori i kësaj Shoqërie ka qenë për përfshirjen e të gjithë detyrimit të krijuar në vitin 2016, si dhe 6 mujorin e parë të vitit 2017, në skemat e Akt-Marrëveshjeve. Sipas këtij propozimi, një gjë e tillë do të lehtësonte përfshirjen në këto skema edhe të familjarëve me të ardhura të ulëta, që nuk kanë arritur të përballojnë likuidimet mujore të faturave korente dhe këstit të përcaktuar nga Aktmarrëveshja.

Këshilli Mbikqyrës i kësaj shoqërie ka vendosur që periudha e mbuluar nga skemat lehtësuese për kategoritë në nevojë të jetë deri në datën 31.12.2016. Gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës së E. K., OSHEE sh.a. ka theksuar faktin se pavarësisht mospërfshirjes në skemat lehtësuese të kategorisë së familjeve me ndihmë ekonomike, detyrimet e së cilave shtrihen përgjatë peridhës 1 janar 2017 e në vijim, politikat orientuese të shtetit shqiptar, të cilat janë ndjekur nga kjo shoqëri në miratimin e Vendimit nr. 64, datë 27.12.2017, të Këshillit Mbikqyrës të OSHEE sh.a., kanë patur në fokus të tyre, subvencionimin e familjeve në nevojë, përfshirë këtu edhe ato familje që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Për sa më sipër, referuar legjislacionit në fuqi, rezulton se familjet në nevojë, përfitojnë kompensim nga shteti për të paguar faturat e energjisë elektrike. Mbështetur në pikën 1, gërma a), të Vendimit nr. 8, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 këh në muaj”* (i ndryshuar) parashikohet:

“1. Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për:

a) familjet, që trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-it, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

b) kryefamiljarët, që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

c) Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror, pension pleqërie fshati ose pension social, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

ç) familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

d) të verbrit;

dh) personat paraplegjikë e tetraplegjikë.

e) Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie ose pension social që janë me banim në fshat, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët."

Referuar pikës 2, të Vendimit nr. 8, datë 14.1.2015, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 këh në muaj", (i ndryshuar), kompensimi për familjet që do të kompensohen, sipas pikës 1, të këtij vendimi, bëhet vetëm për 1 (një) kontratë të energjisë elektrike dhe jepet vetëm një here për një familje, pavarësisht se ato mund të kenë në përbërje edhe të punësuar të tjerë në sektorin buxhetor, të cilët kanë pagë nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, apo persona të paaftë a invalidë, persona që përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo ndihmë ekonomike.

Por, pavarësisht sa më sipër, në kushtet kur, Vendimi nr. 64, datë 27.12.2017, i Këshillit Mbikqyrës të OSHEE sh.a. "Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jofamiljarë" është një akt, i cili përmban parashikime lidhur me skemat lehtësuese dhe kategoritë që do të përfshihen në to, për një periudhë kohe të përcaktuar që ka si kufi datën 31.12.2016, Komisioneri gjykon që Këshilli Mbikqyrës i OSHEE sh.a. duhet të kishte marrë në konsideratë idenë e shtrirjes në kohë të këtij vendimi edhe përgjatë vitit 2017 e ne vijim. Në këtë mënyrë, kjo masë do të cilësohej me karakter pozitiv për ato familje, të cilat janë në pamundësi totale për shlyerjen e detyrimeve të tyre ndaj OSHEE sh.a., sikurse familja e E. K..

Për sa më sipër, KMD gjykon se pavarësisht periudhës, së cilës i përkasin debitë e kategorive në nevojë, mundësia për t'u ofruar kushte lehtësuese për pagesën e tyre, duket të jetë e njëjtë. Familja e E. K., i përket jo vetëm kategorisë së familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, por edhe ka në përbërje të saj një fëmijë me aftësi të kufizuar, gjë që e rëndon pozitën e saj, ekonomike, sepse e bën të pamundur punësimin e njërit prej bashkëshortëve, për të siguruar të ardhura, për të paguar detyrimet ndaj OSHEE sh.a, apo shoqërive të tjera që sigurojnë shërbime për familjarët. Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike duhen trajtuar në mënyrë të njëjtë, pavarësisht periudhës kohore përgjatë së cilës ato mbartin debi ndaj OSHEE sh.a. Nëse për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë miratuar kushte lehtësuese për likuidimin me këste mujore, të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike të krijuara deri në datën **31.12.2016**, e njëjta gjë duhet të bëhet edhe për ato familje që i përkasin të njëjtës kategori, por që debia e tyre i përket një periudhë kohore të mëpasshme.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Vendimi nr. 64, datë 27.12.2017, i Këshillit Mbikqyrës të OSHEE sh.a. “*Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jofamiljarë*” e ka ekspozuar ankuesen, si edhe atë pjesë të familjeve, që i përkasin kategorisë së familjeve, që trajtohen me ndihmë ekonomike, me debi pas datës 31.12.2016, si dhe atë me tepër kur këto familje kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues.

2. Në lidhje me ankesën e E. K. drejtuar Ujësjiellës Kanalizime sh.a., Korçë⁷:

Në bazë të informacionit të marrë nga kjo shoqëri rezulton se detyrimet e prapambetura të familjes së E. K. datojnë që prej muajit mars 2010. Familja e ankueses përfiton nga skemat lehtësuese të UKKO sh.a. dhe sikurse është theksuar në shkresën nr. 356/1, datë 25.06.2018, të UKKO sh.a., kjo shoqëri i ka ofruar klientit mundësinë e nënshkrimit të një aktmarrëveshjeje për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me pjesë sipas mundësisë dhe njëkohësisht vlen për t’u theksuar fakti se pavarësisht detyrimeve të pashlyera, kjo shoqëri nuk ia ka ndërprerë furnizimin me ujë të pijshëm familjes së ankueses.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesja nuk i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e UKKO sh.a.

- 4.** Gjatë analizimit të ankesës së E. K. në tërësinë e saj, Komisioneri gjykon se punësimi i njërit prej bashkëshortëve është i domosdoshëm, për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj UKKO sh.a. dhe OSHEE Korçë. Në kushtet kur, E. K. luan rolin e kujdestares së djalit të saj me aftësi të kufizuara, punësimi i bashkëshortit të saj, Z. Gj. H. duhet të konsiderohet si një çështje me tepër prioritet nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, e cila në shkresën e saj nr. 543, datë 19.06.2018, drejtuar Komisionerit, ka shprehur gatishmërinë e saj për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

⁷ Fillimisht Ujësjiellës Kanalizime Korçë ka funksionuar nën statusin e një “Ndërmarrje Shtetërore” deri në datë 06.06.2000, kohe kur u bë i mundur kalimi nga “Ndërmarrje Shtetërore” në “Shoqëri Aksionare me 100% Kapital Shtetëror” dhe me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë. Ky ndryshim u realizua duke u bazuar në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 ‘Për transferimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare’, me ndryshime, si dhe të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 ‘Për shoqëritë tregtare’. Bazuar në Vendimin Nr. 660, datë 12.09.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjiellësve dhe kanalizimeve njësisive të qeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr. 965, datë 11.12.2007 për zbatimin e VKM “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjiellës – kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe të Urdhërit të Ministrit të METE, Nr. 1049, datë 19.12.2007 ‘Për ndryshime në statutin e Shoqërisë anonime Ujësjiellës SH.A Korçë’, u krye transferimi i aksioneve të shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Korçë, nga pushteti Qëndror, në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore të Bashkisë Korçë, e cila zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë.

5. Lidhur me pretendimin e ankueses, për njohje si vjetërsi në punë, të periudhës që ajo kryen detyrën e kujdetares së djalit të saj autik, Komisioneri vë në dukje faktin se nga korrespondenca zyrtare që ka patur me institucionet kompetente, është vënë në dijeni të faktit se këto institucione janë në procesin e kryerjes së një reforme madhore, lidhur me rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit mbi personat me aftësi të kufizuar. Në kuadër të kësaj reforme, çështja e ngritur nga E. K. do të jetë një nga çështjet që do të trajtohet dhe konsiderohet me prioritet nga institucionet përgjegjëse.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 79, datë 30.05.2018, e Znj. E. K., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Korçë dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a., Korçë.

“Aftësia e kufizuar” dhe “gjendja ekonomike” janë dy prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në kushtet kur, KMD ka konstatuar se familja e ankueses është ekspozuar ndaj një qendrimi të pabarabartë dhe disfavorizues, nga ana e OSHEE sh.a., analizimi i mëposhtëm i shkaqeve dhe lidhjes së tyre me këtë qendrim, do të fokusohet vetëm ndaj këtij subjekti dhe jo ndaj subjekteve të tjera, ndaj të cilave drejtohet ankesa e E. K..

1. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri gjykon se “aftësia e kufizuar” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur.
2. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, Komisioneri gjykon se “gjendja ekonomike” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur, përkatësisht me “gjendjen ekonomike” dhe “aftësinë e kufizuar”.

Komisioneri vlerëson se vendosja e një skeme lehtësuese që prek të gjithë qytetarët e Shqipërisë dhe që tregohet akoma më e ndjeshme kundrejt disa kategorive, të cilat janë më të pamundura që të përballojnë akumulimin e debisë (përfituesit e ndihmës ekonomike, pensionistët, familjet që

kanë në përberje persona me aftësi të kufizuara etj.) është një masë pozitive. Nga ana tjetër vendosja e një afati, brenda të cilit duhet të jetë akumuluar debia, në mënyrë që të përfitohet skema lehtësuese, është një kriter, i cili jo vetëm nuk paraqet arsyeshmëri, as synon përmbushjen e një qëllimi, por vendos në kushte më të disavantazhuara pikërisht ato kategori, të cilat janë më të pamundura për të përballuar pagesën e energjisë elektrike.

Njëkohësisht, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 8, datë 14.01.2015, i cili parashikon kompensim për diferencën e çmimit të energjisë elektrike deri në 300 Këh. Padyshim që edhe kjo është një masë pozitive, por që është dukshëm e pamjaftueshme për kategoritë e pamundura ekonomikisht, si në rastin e E. K., e cila ka akumuluar debi pas hyrjes në fuqi të VKM-së, si dhe pas përfundimit të afatit të parashikuar nga Vendimi nr. 64, datë 27.12.2017, i Këshillit Mbikqyrës të OSHEE sh.a.

Në kushtet kur, familja Kotelli, pavarësisht miratimit të VKM nr. 8/2015, vazhdon akoma të akumulojë debi për shkak të të ardhurave të pamjaftueshme, Vendimi i sipërpërmendur i Këshillit Mbikqyrës së OSHEE sh.a., në momentin që vendos një afat kohor të paarsyeshëm dhe jo në përmbushje të një qëllimi specifik, ndodhet në kushtet e diskriminimit të tërthortë ose indirekt. Në këtë kontekst, me diskriminim të tërthortë duhet kuptuar *“ajo formë e diskriminimit që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paarsyeshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash, në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter apo praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjestim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”*.

Në rastin konkret, është e vërtetë që kriteri kohor prek të gjithë qytetarët pa asnjë lloj dallimi, por është pikërisht pasoja disavantazhuese që ajo gjeneron mbi kategoritë e njerëzve në nevojë, të cilët përfitojnë vetëm ndihma nga shteti, si dhe ndodhen edhe në kushte papunësie, të cilët janë të pamundur që të paguajnë energjinë që konsumojnë dhe debinë që kanë akumuluar për energjinë e konsumuar më parë që e bën atë diskriminuese.

Në ndjekjen e kësaj llogjike, Komisioneri mbështetet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në çështje të tilla si Biao kundër Danimarkës⁸, 24 Maj 2016, ku ndër të tjera gjykata shprehet: *“Dallimi në trajtim është diskriminues nëse nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet.....Një politikë ose masë e përgjithshme që ka efekte paragjyquese në mënyrë jo proporcionale në një grup të caktuar mund të konsiderohet diskriminues edhe kur nuk ka për qëllim specifik atë grup dhe nuk ka qëllime diskriminuese.*

⁸Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të vitit 2016, botim i Avokaturës së Shtetit, çështja Biao kundër Denmark, 24 Maj 2016, i GJEDNJ-së, paragrafi 90-91 Aplikimi nr. 38590/10;, fq. 323-324.

Megjithatë, ky është rasti vetëm nëse politika ose një masë e tillë nuk ka ndonjë justifikim “objektiv dhe të arsyeshëm”.

Një konstatim i ngjashëm vihet re edhe në çështjen DH dhe të tjerë kundër Republikës Çeke (2006)⁹, ku GJEDNJ shprehet se: *“Një ndryshim në trajtim pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm mund të shkelë nenin 14 edhe pse mungon synimi diskriminues. Kështu, kur është treguar se legjislacioni prodhon një efekt diskriminues të pajustificuar, nuk është e nevojshme të dëshmohet ndonjë qëllim diskriminues nga ana e autoriteteve përkatëse.”*

Nisur nga sa më sipër, vendosja e një afati kohor, brenda së cilit mund të përfitohet skema lehtësuese, për aq kohë sa nuk ka një përligje të arsyeshme dhe objektive, si dhe nuk përmbush ndonjë qëllim, është diskriminuese dhe si rrjedhojë duhet ndryshuar, duke hequr afatin e vendosur.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 17 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”, së Znj. E. K., nga ana e OSHEE sh.a., nëpërmjet Vendimit nr. 64, datë 27.12.2017, të Këshillit të saj Mbikqyrës *“Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jofamiljarë”*.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”, së Znj. E. K., nga ana e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a. Korçë.
3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, OSHEE sh.a. të marrë të gjithë masat e nevojshme për rregullimin e situatës diskriminuese, nëpërmjet amendimit të vendimit të sipërpërmendur ose miratimit të një vendimi të ri.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, OSHEE sh.a., të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

⁹ Shih DH dhe të tjerë kundër Republikës Çeke [GC], (2006), nr.57325 / 06, § 234-235;

5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Rekomandohet që familja e ankueses, të lidhë Akt-marrëveshje me Ujësjiellës Kanalizime sh.a., Korçë, për të përfituar nga skemat lehtësuese të ofruara nga kjo shoqëri, për të shlyer detyrimet e prapambetura.
7. Të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, lidhur me punësimin e Z. Gj. H., si dhe të njoftohet Komisioneri mbi to.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda afateve ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Fusha – te mira dhe shërbime
Shkak - “aftësia e kufizuar”, “gjendja ekonomike”)